

Komente mbi Projekt Strategjinë Kombëtare Industriale 2026–2030

Confindustria Albania vlerëson punën e bërë për hartimin e Strategjisë Kombëtare Industriale 2026–2030 dhe e konsideron pozitiv faktin që Shqipëria synon të ndërtojë një politikë industriale të harmonizuar me prioritetet e Bashkimit Evropian. Dokumenti paraqet një vizion të qartë për transformimin industrial, duke vendosur theksin te inovacioni, digjitalizimi, tranzicioni i gjelbër dhe integrimi në zinxhirët evropianë të vlerës.

Megjithatë, gjatë leximit të dokumentit krijohet përshtypja se strategjia është ndërtuar më shumë mbi kuadrin metodologjik dhe dokumentet referuese të Bashkimit Evropian sesa mbi një analizë të thelluar të industrisë shqiptare. Referencat ndaj dokumenteve strategjike evropiane janë të shumta dhe të rëndësishme, por ato nuk mund të zëvendësojnë analizën e realitetit ekonomik mbi të cilin do të zbatohet kjo strategji. Një politikë industriale kombëtare duhet të mbështetet, para së gjithash, në njohjen e strukturës së industrisë që synon të zhvillojë.

Në këtë aspekt, do të ishte me vlerë që dokumenti të përfshinte një diagnozë më të detajuar të industrisë shqiptare. Strategjia paraqet në mënyrë të përgjithshme potencialin industrial të vendit, por nuk ofron një analizë sektoriale që të shpjegojë se ku ndodhet sot industria shqiptare, cilët sektorë kanë peshën kryesore në ekonomi, cilët gjenerojnë vlerë të shtuar dhe eksporte, cilët kanë potencial zhvillimi dhe cilat janë pengesat specifike me të cilat përballen. Një analizë e tillë do të krijonte një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet situatës aktuale dhe masave që propozon Strategjia.

Në të njëjtën linjë, vihet re se dokumenti shtyn për një fazë të mëvonshme identifikimin e ekosistemeve prioritare industriale përmes procesit të Specializimit Inteligjent (S3). Edhe pse kjo qasje është metodologjiksht e justifikuar, do të ishte e dobishme që një Strategji Kombëtare Industriale të jepte që në këtë fazë një orientim më të qartë mbi sektorët që konsiderohen prioritarë për zhvillimin industrial të vendit. Kjo do të krijonte më shumë siguri për biznesin dhe investorët dhe do të ndihmonte në orientimin e politikave publike.

Një element tjetër që meriton vëmendje është analiza e faktorëve që ndikojnë drejtpërdrejt konkurrueshmërinë e industrisë. Dokumenti fokusohet kryesisht te objektivat strategjike dhe mekanizmat institucionalë të zbatimit, ndërsa trajton në mënyrë të kufizuar problematikat që sipërmarrjet hasin në praktikë. Çështje si kostot e energjisë, qasja në financim, mungesa e fuqisë punëtore të kualifikuar, kostot logjistike, infrastruktura industriale, barra administrative dhe informaliteti janë faktorë që ndikojnë çdo ditë në vendimarrjen e investorëve dhe në

konkurrueshmërinë e industrisë shqiptare. Një analizë më e plotë e këtyre elementeve do ta bënte strategjinë më të lidhur me realitetin ekonomik.

Po kështu, megjithëse Strategjia parashikon objektiva ambiciozë, do të ishte e rëndësishme që ajo të shoqërohej me një pasqyrë më të qartë të mekanizmave të financimit. Dokumenti nuk e bën gjithmonë të qartë se cilat masa do të financohen nga buxheti i shtetit, cilat do të mbështeten nga fondet e Bashkimit Evropian dhe cilat pritet të realizohen përmes investimeve private. Një dimension financiar më i detajuar do të rriste besueshmërinë e dokumentit dhe do të lehtësonte monitorimin e zbatimit të tij.

Nga ana tjetër, Strategjia i kushton rëndësi bashkëpunimit ndërmjet institucioneve publike, biznesit dhe akademisë, por roli i sektorit privat mbetet i përshkruar në terma të përgjithshëm. Do të ishte e dobishme të përcaktoheshin mekanizma më konkretë për përfshirjen e organizatave përfaqësuese të biznesit në monitorimin dhe përditësimin periodik të Strategjisë. Përvoja ndërkombëtare tregon se politikat industriale janë më efektive kur sektori privat nuk është vetëm subjekt konsultimi, por partner aktiv në procesin e zbatimit.

Gjithashtu, Strategjia mund të përfitonte nga një dimension territorial më i zhvilluar. Dokumenti trajton zhvillimin industrial në nivel kombëtar, por nuk evidenton mjaftueshëm potencialin dhe karakteristikat e rajoneve të ndryshme të vendit. Një analizë e tillë do të ndihmonte në orientimin më të mirë të investimeve dhe në zhvillimin e poleve industriale sipas avantazheve krahasuese të secilit rajon.

Së fundi, konsiderojmë se dokumenti do të ishte më i plotë nëse do të shoqërohej me një analizë të rreziqeve që mund të ndikojnë realizimin e objektivave të tij. Fenomene si mungesa e fuqisë punëtore, zhvillimet gjeopolitike, ndërprerjet e zinxhirëve të furnizimit, ndryshimet klimatike apo pasiguritë ekonomike ndërkombëtare përbëjnë faktorë që mund të ndikojnë ndjeshëm zhvillimin industrial dhe do të ishte e dobishme që Strategjia të parashikonte edhe mënyrën se si synon t'i adresojë ato.

Confindustria Albania e konsideron Strategjinë Kombëtare Industriale një hap të rëndësishëm drejt ndërtimit të një politike moderne industriale dhe vlerëson harmonizimin e saj me kuadrin strategjik të Bashkimit Evropian. Megjithatë, dokumenti do të fitonte më shumë forcë nëse do të mbështetej në një analizë më të thelluar të strukturës së industrisë shqiptare, në identifikimin më të qartë të sektorëve prioritarë dhe në një lidhje më të drejtpërdrejtë ndërmjet objektivave strategjike dhe sfidave konkrete me të cilat përballen sot biznesi. Kjo do ta bënte strategjinë jo vetëm një dokument të mirë politikash, por edhe një instrument praktik zhvillimi për industrinë shqiptare.